



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis

Të dhënat themelore për programin e studimit : Mastër në MENAXHMENT DHE TURIZËM
TË QËNDRUESHËM

"

Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Programi i Master në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm synon të pajisë studentët me njohuritë , kompetencat te specializuara , aftësitë e nevojshme për të udhëhequr dhe kontribuar në zhvillimin industrisë turistike të qëndrueshme. Përmes një qasje multidisiplinore, studentët do të fitojnë njohuri të thellë të aspekteve mjedisore, sociale dhe ekonomike të turizmit, duke iu mundësuar ata të projektojnë, implementojnë dhe menaxhojnë nismat turistike që minimizojnë ndikimet negative, promovojnë përfshirjen komunitare dhe ndihmojnë në promovimin e qëndrueshmërisë afatgjatë në sektorin e turizmit. Fakulteti i MTHM-së siguron funksionimin e tij në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e Universitetit “Haxhi Zeka”, të cilat respektojnë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Realizimi i misionit dhe objektivave të programit studimor do të ndodhë përmes pjesëmarrjes aktive të studentëve dhe të gjithë stafit akademik në kërkime të ndërmarrura në fushën e Menaxhmentit dhe Turizmit të Qëndrueshëm. Rezultatet e synuara të mësimit në këtë program janë përcaktuar duke pasur këshilla relevante akademike dhe profesionale. Gjatë zhvillimit të programit, kemi konsultuar me një varg akterësh të fushës, duke përfshirë Trupat Këshillëdhënëse, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, Komunën e Pejës, OJQ Let's do it Peja, bizneset turistike si dhe profesorë universitarë me përvojë në fushën e turizmit nga universitetet e tjera. Rekomandimet dhe sugjerimet e nxjerra nga këto konsultime janë inkorporuar në hartimin e këtij programi. Ky proces ka siguruar që programi të përputhet me aftësitë dhe kompetencat e parashikuara në
---	---

	Programi ofron një kurrikulë të pasur dhe të përshtatshme, e cila përfshin lëndë obligative dhe zgjedhore, si dhe praktiken profesionale. Njohuritë e fituara përmes këtij programi do të përdoren për të përgatitur të diplomuarit për të punuar në kompani private dhe publike, themelimin e bizneseve të reja, veçanërisht në zonat rurale dhe ubrane. Programi, i cili nuk është thjesht i krijuar për studentët që janë të interesuar të përgatiten për menaxhimin dhe zbatimin e turizmit në një mënyrë të qëndrueshme, por gjithashtu ofron mundësi për përfitime ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe nxitjen e qëndrueshmërisë së turizmit. Koncepti didaktik dhe kërkimor i programit të studimit është mirë-përcaktuar. Si rezultat i këtij qëndrimi ndaj mënyrës së studimit, metodave të hulumtimit dhe mënyrave të mësimin të ofruara nga ky program, studentët kanë mundësinë për të fituar njohuri të përparura dhe të pranueshme në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të turizmit.
Rezultatet e pritshme të nxënësit:	Rezultatet e pritshme për studentin nga mësim-nxënja janë: - Njohuri të specializuara bashkëkohore në fushën e turizmit, sipas standardeve të pranura ndërkombëtarisht për arsimin e lartë. - Njohuri të avancuar bashkëkohore në industrinë e turizmit, trendeve vendore dhe mundësive të saj në kontekstin e qëndrueshmërisë. - Njohuri të specializuara për të zhvilluar dhe promovuar turizmin e qëndrueshëm në vend dhe rajon. - Njohuri teorike dhe praktike në lidhje me aspektet ekonomike, sociale dhe mjedisore të turizmit - Njohuri të përgjithshme për praktikën dhe strategjitë për të zhvilluar destinacione turistike të qëndrueshme, duke përfshirë menaxhimin e burimeve natyrore dhe kulturore. - Njohuri për politikën dhe strategjitë që promovojnë turizmin e qëndrueshëm duke përfshirë ligjet dhe rregulloren që mbrojnë mjedisin, trashëgiminë dhe kulturën. - Ta kuptojë rolin e turizmit të qëndrueshëm dhe rëndësinë e tij për zhvillimin ekonomik. Aftësitë:

- Aftësitë për të identifikuar, analizuar dhe zgjidhur problemet komplekse në lidhje me menaxhimin e turizmit të qëndrueshëm.
- Aftësi për të kuptuar dhe vlerësuar impaktin e Turizmit në mjedis, kulturë, ekonomi dhe komunitete vendase.
- Aftësi për të menaxhuar burimet natyrore, trashëgëmin dhe kulturën në mënyrës që të mbrohen dhe ruhen si pjesë e një strategjie të qëndrueshme të zhvillimit të Turizmit.
- Aftësi për të krijuar strategji dhe planifikime të qëndrueshme për zhvillimin e destinacioneve turistike, duke përfshirë diversifikimin e ofertës së Turizmit.
- Aftësi për të ndërtuar marrëdhënie të mira dhe të qëndrueshme me komunitetet vendase për të siguruar pjesëmarrje dhe përfitime të drejtëpërdrejta në turizëm
- Aftësi për të identifikuar rreziqe potenciale dhe të planifikojë për reagime efektive në situata emergjente ose kriza që mund të ndikojnë në industrinë e turizmit.
- Aftësi për të përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit për të përmirësuar eksperiencën e vizitorëve për të inovuar në ofertën e turizmit.
- Aftësi për të zhvilluar dhe zbatuar politika dhe strategji të orientuara nga qëndrueshmëria në sektorin e turizmit

Kompetencat:

- Aftësi për të kuptuar dhe vlerësuar ndikimin e turizmit në mjedis, kulturë, ekonomi dhe komunitete vendase për të zhvilluar strategji të qëndrueshme.
- Aftësi për të planifikuar dhe zhvilluar destinacione turistike në mënyrë që të jenë tërheqëse, por të respektojnë dhe të mbrojnë vlerat natyrore, trashëgëmin dhe kulturën.
- Aftësi për të përfshirë dhe bashkëpunuar me komunitetet vendase për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin dhe përfitimet nga turizmi.

	- Aftësi për të komunikuar dhe promovuar praktikat e qëndrueshme të turizmit, duke përdorur strategji efektive të marketingut dhe komunikimit - Aftësia për të kontribuar në punën ekipore në një grup ndër-kulturor, për të treguar kapacitetet e liderit gjatë planifikimit dhe organizimit të kohës, si dhe kryerjen e detyrave të avancuara brenda afatit të specifikuar kohor. - Aftësi për të analizuar nevojat e tregut, planet për zhvillim, relacionet, destinacionet, çmimet, aktivitetet promovuese dhe shitjet; - Për të demonstruar të kuptuarit konceptual të avancuar të specifikave, dinamikës, aspekteve ndërdisiplinore dhe tendencave për menaxhimin e turizmit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. - Për të udhëhequr aktivitetet shkencore dhe (ose) praktike në grupet e ndryshme të punës të natyrës ndërkombëtare mbi kërkesat e etikës profesionale, parimet e njeriut, barazisë dhe mos-diskriminimit, duke respektuar dallimet kulturore dhe parimet morale. - Për të zhvilluar zgjidhje inovative duke vlerësuar pasojat e mundshme sociale, mjedisore dhe ekonomike, duke kuptuar përgjegjësinë morale për aktivitetet e veta dhe ndikimin e rezultatet e tyre në kontekste të ndryshme. - Të analizojnë raportet mes teorisë - praktikës dhe metodologjive të studimit e hulumtimit: të dizajnojnë, implementojnë hulumtimet dhe t'i interpretojnë rezultatet
Procedurat e mësimdhënies:	Forma tradicionale e mësimdhënies në Fakultet shpesh përfshin dhënien e ligjëratave për grupe të mëdha studentësh, të shoqëruar nga mësimet dhe seminare, me disa studime të pavarura. Megjithatë, ka disa mënyra të tjera të mësimdhënies që gjithashtu do të aplikohen në këtë program dhe kanë rezultuar të jenë shumë efektive, të tilla si “klasa e kthyer” (blended learning) dhe mësimi i bazuar në probleme (problem based learning) dhe të tjera siç janë paraqitur në vijim: - “Flipped Classroom”: do të merret parasysh një qasje të "flipped" duke i kërkuar studentëve të shikojnë përmbajtje

	video para ligjëratave dhe t'i kushtojnë kohë në klasë ushtrimeve, projekteve dhe diskutimeve. - Mësim aktiv duke eksploruar metodat e mësimdhënies dhe mësimin që e bëjnë studentin përgjegjës për të mësuarit e tyre përmes aktiviteteve kuptimplota. - Mësimi i bazuar në problem ku studentet janë në qendër të vëmendjes dhe mësojnë rreth një lënde përmes kuptimit dhe zgjidhjes së problemeve (raste praktike). - Mësimi i bazuar në punë që siguron studentët për të mësuar nëpërmjet përvojave të punës në jetën reale. - Studime të kombinuara (blended learning) që parasheh mësimdhënie tradicionale në klasë e kombinuar me mësimin në internet dhe studimin e pavarur. - Mësimi i udhëhequr nga studentët ku studentët punojnë së bashku për të mbështetur mësimin e njëri-tjetrit.												
Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve);	Sipas nenit 104, 105, 106 të Statutit të UHZ, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet me anë të testimit me shkrim dhe me gojë. Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimdhënësi i lëndës. Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit përmes testeve, punimeve, seminareve, pjesëmarrjeve në projekte, konferenca shkencore, etj. Metodat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lënde mësimore veç e veç në kuadër të programit. Një shembull vlerësimi është si më poshtë: <table> <tr> <td>Pjesëmarrja aktive në mësim.....</td> <td>10 %</td> </tr> <tr> <td>Dertyrat, ushtrimet.....</td> <td>10 %</td> </tr> <tr> <td>Testi i parë.....</td> <td>20 %</td> </tr> <tr> <td>Testi i dytë.....</td> <td>20 %</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar.....</td> <td>40 %</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>100%</td> </tr> </table>	Pjesëmarrja aktive në mësim.....	10 %	Dertyrat, ushtrimet.....	10 %	Testi i parë.....	20 %	Testi i dytë.....	20 %	Provimi përfundimtar.....	40 %	Total	100%
Pjesëmarrja aktive në mësim.....	10 %												
Dertyrat, ushtrimet.....	10 %												
Testi i parë.....	20 %												
Testi i dytë.....	20 %												
Provimi përfundimtar.....	40 %												
Total	100%												

	Gjersa, një shembull i kriterit të notimit është si në vijim: 0-50.99%(5) 51-60.99%(6) 61-70.99%(7) 71-80.99%(8) 81-90.99%(9) 91-100%(10)
Modulet /Lëndët (titujt):	Viti I - Metodologjia e kërkimit shkencor. - Korniza ligjore për drejtimin udhëheqjen e menaxhimit të destinacioneve turistike. - Çështje bashkëkohore në menaxhimin e burimeve njerëzore. - Trashëgimia kulturore në turizëm. - Zhvillimi i produkteve specifike turistike. - Teknologjia e informacionit dhe inovacioni në turizëm - Transporti në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm - Menaxhimi i projekteve në turizëm - Qëndrueshmëria e turizmit dhe ndryshimet klimatike - Menaxhimi i zhvillimit të qëndrueshëm në destinacionet turistike - Ndërmarrësia e gjelbër. - Marketing në turizmëm Viti II - Menaxhimi financiar për zhvillimin e turizmit - Praktikë profesionale në turizëm - Burime e turizmit natyror - Agroturizmi - Etika mjedisore dhe ndryshimi i sjelljes - Menaxhimi i atraksioneve turistike
Numri i vendeve të studimit:	25 në gjuhë shqipe
Udhëheqës i drejtimit/programit të studimit:	1. Prof. Asosc dr. Alberta Tahiri 2. Prof. ass. Shyhrete Muriqi
Personeli i përhershëm shkencor/artistik: (Numri sipas kategorive të personelit)	5 profesorë të rregulltë, 6 profesorë të asocuar, 2 profesorë asistent dhe 1 asistentë.

Taksat e studimit:	Studimet janë falas Vërejtje: Në rast kur përsëritet vitit, bëhet pagesa sipas Udhëzimit Administrativ MASHTI Nr.09/2021.
Mundësitë e punësimit pas diplomimit:	- Sektori privat - Menaxher apo asistent menaxher në kompani private - Specialist ne turizëm te qëndrueshëm - Koordinator projektsh turizëm - Sipërmarrje dhe start-up - Themelues i një biznesi të ri (sipërmarrës) - Menaxher zhvillimi biznesi në start-up - Menaxher produkti apo inovacioni ne turizëm - Konsulent për rritje Fushën Turizmit - Konsulentë dhe analiza biznesi ne turizëm - Konsulent biznesi apo strategjie ne turizëm - Analist të dhënash apo tregu ne turizëm - Arsimin parauniversitar dhe universitar - Mësues i lëndëve ekonomike në shkolla të mesme ne fushën e turizmit (pas trajnimeve shtesë) - Asistent mësimdhënieje apo kërkimi në universitet
Emri i institucionit:	Universiteti Haxhi Zeka
Fakulteti/Departamenti:	Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis
Kampusi qendrorë apo i degës:	Kampusi qendror/ Main Campus
Specifikoni për cilin kampus jeni duke aplikuar:	Click or tap here to enter text.
Emri i programit të studimit:	Menaxhimi i Marketingut Turistik
Personi udhëheqës i programit:	Prof.asoc.dr.Alberta Tahiri
Akreditim/Riakreditim:	Akreditim/ Accreditation

Niveli i kualifikimit sipas KKK:	ISCED 7
Diploma akademike apo emërtimi i diplomës:	Master i Shkencës në MENAXHMENT DHE TURIZËM TË QËNDRUESHËM
ECTS:	120
Specializimet / Koncentrimet:	Click or tap here to enter text.
Kodi i Zonës së Subjektit Erasmus (ESAC):	04.7 04.0
Forma e studimeve:	Të rregullta Shqip / Full Time
Kohëzgjatja minimale e studimeve:	2 vite akademike
Numri i vendeve të studimit / Kuota:	25 Gjuhë Shqipe
Personeli i përhershëm shkencor/artistik për programin e studimit (së paku 3 PhD):	Prof.Asoc Alberta Tahiri Prof.Ass.Dr.Shyhrete Muriqi Prof .Asoc.Dr. Beke Kuqi